

**AKT-THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"JU.AL" shpk**

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 11.06.2024 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "JU.AL" shpk.
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
  - 1- **JULIAN BASHMILI**, shtetas Shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I30126023V i datelindjes 26.01.1983, lindur në Gostime dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë per te vepruar.
  - 2- **ILIR BILIBASHI**, shtetas Shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I21226142L, i datelindjes 26.12.1982, lindur në Nepravishte dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë per te vepruar.
  - 3- **ARBEN SELFO**, shtetas Shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi H50704035W, i datelindjes 04.07.1975 lindur ne Leskovik dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

**Neni 2:**

**Objekti**

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e meposhtem:

Import, eksport, tregti me shumice ose pakice te produkteve te ndryshme industriale, pergjithesisht lodra dhe artikuj te argetimit per femije dhe te rritur si dhe çdo aktivitet tjeter i cili nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:**

**Selia**

1. **Shoqëria e ka selinë në:**

Farke, Selite, Rruga Rexhep Pinari, godine 5 kateshe nr. 24 Tirane.

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II**  
**KAPITAL**  
**I**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njqindmije) Lekë dhe është i ndarë në 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a- Ortaku themelues **JULIAN BASHMILI**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhjetë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

b- Ortaku themelues **ILIR BILIBASHI**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 30,000 (tri dhjetë mijë) Lekë, që përben 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

c- Ortaku themelues **ARBEN SELFO**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 20,000 (njetëzete mijë) Lekë, që përben 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b. shitblerjes;
  - c. trashëgimisë;
  - d. dhurimit;
  - e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

1. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit

sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj

3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;  
pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9**  
**Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së**  
**Përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10**  
**Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 35 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 11**  
**Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
  - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d. përcaktimin e shpërblimeve
  - e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 12**  
**Përfundimi nga e drejta e**  
**votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

- d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.  
Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 13**  
**Administrimi**

1. Administratori i shoqërisë emërohet z. ILIR BILIBASHI me numer id. I21226142L, i datëlindjes 26.12.1982, lindur në Nepravishte dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
4. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
  - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

**Neni 16**  
**Viti Financiar**

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Ekspertet**

1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**KREU V**  
**PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**  
**Prishja dhe**  
**likuidimi**

1. Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
    - a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
    - b. me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
    - c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
    - d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
    - e. me vendim të gjykatës;
- Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".
- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posacme të njohura nga ligji.

O R T A K Ë T  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"JU.AL" shpk

JULIAN BASHMILI

ILIR BILIBASHI

ARBEN SELFO



Faqe 7

JU.AL shpk